

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE GJILAN/ Departamenti i përgjithshëm, përmes gjyqtarit të vetëm gjykues Behar Ymeri, me sekretaren juridike Igballe Azemi, ne çështjen penale ndaj të akuzuarit F.S. nga ... rr. ... nr.... të cilin me autorizim e përfaqëson avokati N.N. nga ..., për shkak të veprës penale rrezikim i trafikut publik nga neni 378 paragrafi 8, lidhur me paragrafin 6 e 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës¹, i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan, PP.II.Nr.2228/2016 të datës 28.12.2016, të cilën e përfaqëson prokurori Ismet Ukshini, pas mbajtjes të shqyrtimit fillestar më datë 24.01.2018, mori dhe shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I Pandehuri **F.S.**, nga i ati Xh., e ëma S., e lindur Sh., i lindur më dt.data e lindjes..., në fsh. ...K. ..., tani me vendbanim në ..., Rruga ... nr. ..., ka të kryer shkollën fillore, i martuar, baba i dy fëmijëve, i punësuar N.P. ..., i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i R. Kosovës, më parë i pa dënuar dhe nuk udhëhiqet procedurë tjetër penale.

Ë S H T Ë F A J T O R

Sepse më datë ..., rreth orës 16.30 h, në ..., në rrugën ... prej rrugës së ...në drejtim të auto tregut, me të kaluar udhëkryqin me të arritur para marketit ... duke drejtuar automjetin e udhëtarëve ... me targa të regjistrimit ..., ka shkelur paragrafin 53,1 të Ligjit nr. 05/L-088 për rregullat e trafikut rrugor, ka rrezikuar jetën e njerëzve dhe me këtë rast i ka shkaktuar lëndime trupore këmbësore tani të dëmtuarës K.Sh. nga ..., në atë mënyrë që nuk i është përmbajtur dispozitave të lartë përmendura të Ligjit në fjalë që kanë të bëjnë me obligimin e shoferit sipas të cilit -shoferi duhet tia përshtat shpejtësinë e lëvizjes kushteve dhe fushëpamjes së rrugës, gjendjes dhe llojit të rrugës, kushteve teknike, kushteve atmosferike, ngarkesës së automjetit dendësisë së trafikut, ashtu që të jetë në gjendje ta ndal mjetin para çdo pengese që mund të paraqitet në kushtet e dhëna brenda kufijve të fushëpamjes përkatësisht të mund të veprojnë me kohë, lehtë ka menduar se edhe përkundër këtij lëshimi nuk do të shkaktoj pasojë të ndaluar, ashtu që me të arritur në vendin e përmendur me kohë nuk mund ta ndal automjetin dhe për pasojë me pjesën e përparme të automjetit godet këmbësoren tani të dëmtuarën, me këtë rast të njëjtës i shkakton lëndime të rënda trupore.

-me çka ka kryer veprën penale rrezikimi i trafikut publik, nga neni 378 paragrafi 8 lidhur me paragrafin 6 e 1 të KPRK-së.

Prandaj gjykata duke ju referuar marrëveshjes së arritur me shkrim mbi pranimin e fajësisë të akuzuarit F.S., në bazë të dispozitës ligjore dhe neneve 4, 41, 42, 45, 47,73,74,75 si dhe neneve 233 dhe 365 të Kodit Procedurës Penale të Republikës së Kosovës, të akuzuarin:

E G J Y K O N

I. Ndaj të pandehurit F.S., shqiptohet dënim me burg në kohëzgjatje prej 145 (njëqind e dyzet e pesë) ditë, i cili dënim do të ekzekutohet pasi që aktgjykimi të bëhet i formës së prerë.

II. Në bazë të nenit 47 të KP-s dhe me pëlqimin e të pandehurit F.S. dënimi me burgim në kohëzgjatje prej 145 (njëqind e dyzet e pesë) ditë i **zëvendësohet** në dënim me gjobë në shumë

¹ *Kodi Penal i Republikës së Kosovës (Në tekstin e mëtejshëm KPRK), nr.04/L-082, i datës 20.04.2012, i cili ka hyrë në fuqi më 01.01.2013.*

prej 1,450 € (njëmijë e katërqind e pesëdhjetë euro). nëse nuk e paguan dënimin me gjobë, dënimi me gjobë revokohet dhe do të ekzekutohet dënimi me 145 ditë burg.

E dëmtuara, për realizimin e kërkesës pasurore juridike të udhëzohet në kontest juridiko civil.

I pandehuri obligohet të paguaj shpenzimet e procedurës penale në shumën prej 20.00 € (njëzet euro), në afatin prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit, nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm.

Të akuzuarit i shqiptohet taksa për kompensimin e viktimave të krimit, në shumën prej 30.00 € (tridhjetë euro), në bazë të nenit 39 paragrafi 3, nën paragrafi 1.3 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

ARSYETIM

1. Historiku i procedurës

Prokuroria Themelore në Gjilan, Departamenti i Përgjithshëm, më datë 28.12.2016 ka ngritur aktakuzën e lartcekur, ndaj të akuzuarit F.S., nga ..., për shkak të veprës penale, rrezikim i trafikut publik nga neni 378 paragrafi 8, lidhur me paragrafin 6 e 1 të KPRK-së. Po ashtu me datën 28.12.2016, në këtë gjykatë është dorëzuar edhe një marrëveshje për pranimin e fajësisë lidhur në mes Prokurorisë Themelore në Gjilan/Departamenti i përgjithshëm në njërën anë dhe në anën tjetër të pandehurit F.S., me mbrojtësin e tij N.N. nga Sipas kësaj marrëveshje, kësaj Gjykate i është rekomanduar, që ndaj të akuzuarit F.S., për shkak të veprës penale, ti shqiptohet dënim me burg në kohëzgjatje prej 145 ditë me mundësi yëvendsimi me dënim me gjobë.

2. Vlerësimi i marrëveshjes për pranimin e fajësisë

Në shqyrtimin fillestar dhe publik, të mbajtur më datë 24.01.2018, gjykata pas dëgjimit të palëve dhe të mbrojtësit, ka pranuar marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë, ngase ka konstatuar se janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore për një gjë të tillë. Në këtë aspekt gjykata ka konstatuar se i pandehuri e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, se pranimi është bërë në mënyrë vullnetare nga i akuzuari dhe pas konsultimit të mjaftueshme me mbrojtësin e tij avokat N.N., se i akuzuari nuk ka qenë në asnjë mënyrë i detyruar apo i shtrënguar në asnjë mënyrë të pranoj fajësinë, se pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza dhe se nuk ekziston asnjë nga rrethanat e parapara në nenin 253 paragrafi 1 të KPP-s.

3. Gjendja faktike e vërtetuar

Andaj, duke u bazuar në këto që u cekën më lart, gjykata e ka vërtetuar këtë gjendje faktike, duke u bazuar në format e kualifikuara të kësaj vepre, ekziston fakti se i akuzuari F.S. ka kryer veprën penale rrezikimi i trafikut publik, nga neni 378 paragrafi 8 lidhur me paragrafin 6 e 1 të KPRK-së dhe ka shkel nenin 53 paragrafi 1 të Ligjit për Rregullat e Trafikut Rrugor të Kosovës, në kohën, vendin, dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

4. Elementet e veprës penale

Gjykata, pas dëgjimit të deklaratave të palëve dhe të mbrojtësit lidhur me dënimin, e ka shpallur fajtor të akuzuarin F.S., për shkak të veprës penale rrezikimi i trafikut publik, nga neni 378 paragrafi 8 lidhur me paragrafin 6 e 1 të KPRK-së dhe nenin 53 paragrafi 1 të Ligjit për Rregullat e Trafikut Rrugor të Kosovës. Ngase veprimet e të njëjtit i përmbajnë të gjitha tiparet e veprës penale dhe se për të njëjtën është dhe penalisht përgjegjës. Kjo për faktin se i njëjti siç e ka pranuar edhe vet, duke mos përshtatur shpejtësinë e lëvizjes kushteve në rrugë e ka goditur këmbësoren.

5. Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit

Gjykata, me rastin e shqiptimit të dënimit, ka vlerësuar se duhet të pranohet rekomandimi i paraqitur me marrëveshjen për pranimin e fajësisë, që të akuzuarit F.S. ti shqiptohet dënim me burg në kohëzgjatje prej 145 ditë me mundësi zëvendësimi me dënim me gjobë, ngase ka vlerësuar se duke i marrë për bazë të gjitha rrethanat e shënuara më poshtë, të cilat duke i ndërlidhur njëra me tjetrën, janë vlerësuar rrethana posaçërisht lehtësuese, ky dënim do të jetë një dënim i drejtë dhe në harmoni me peshën e veprës penale. Me rastin e matjes së dënimit të akuzuarit, gjykata ka marrë për bazë të gjitha rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, të parashikuara në nenin 73 dhe 76 të KPRK-s, Kështu, si rrethanë posaçërisht lehtësuese, mbi bazën e së cilës gjykata e ka zbutur dënimin dhe ndaj të akuzuarit ka shqiptuar dënim nën minimumin e posaçëm, është fakti se i akuzuari ka arritur marrëveshjen për pranimin e fajësisë me Prokurorinë Themelore në Gjilan / Departamenti i përgjithshëm. Gjithashtu, si rrethana posaçërisht lehtësuese, gjykata ka marrë dhe faktin se i akuzuari ka bashkëpunuar me prokurorin e shtetit, se pranimin e fajësisë e ka bërë në të gjitha fazat e procedurës penale, se i akuzuari është pënduar thellë për kryerjen e kësaj vepre penale, se i njëjti ka premtuar se nuk do të kryej vepra tjera penale, sjellje korrekte gjatë shqyrtimit fillestar dhe fakti që nuk ka qenë i dënuar më parë për ndonjë vepër penale të kësaj natyre. Këto janë rrethana, që tregojnë se edhe me një dënim më të butë mund të arrihet qëllimi i dënimit dhe i akuzuari me të drejtë mund të pritët që në të ardhmen nuk do të kryej vepra tjera penale. Ndërsa, rrethanë rënduese është lëndimet e rënda trupore të dëmtuarës.

6. Shqiptimi i dënimit në harmoni me peshën e veprës penale dhe me shkallën e përgjegjësisë penale të pandehurit dhe qëllimi i dënimit të shqiptuar

Gjykata, ka konstatuar se me dënim me burg në kohëzgjatje prej 145 ditë me zëvendësim me dënim me gjobë në shumë prej 1,450 euro, mund të arrihet edhe qëllimi i dënimit, nga neni 41 i KPRK, i cili konsiston në parandalimin e të pandehurit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij, të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

7. Vendimi mbi kërkesën pasurore juridike

Duke bazuar në nenin 463 paragrafi 2 të KPP, e dëmtuara për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

9. Vendimi për shpenzimet e procedurës penale

Duke e pasur natyrën e kësaj çështje penale dhe gjendjen financiare e të pandehurit, gjykata, duke u bazuar në nenin 451 paragrafi 1 të KPP, ka vendosur që të pandehurin ta detyrojë për ta paguar shpenzimet e procedurës penale, dhe paushallin gjyqësor, si dhe taksa për Kompensimin e Viktimave në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita kur ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë. Duke u bazuar në këto që u cekën më lart, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN
Departamenti i Përgjithshëm
P.nr.20/2017-Më 24.01.2018

Sekretarja juridike,
Igballe Azemi d.v

Gjyqtari,
Behar Ymeri d.v

KËSHILLA JURIDIKE : Kundër këtij aktgjykimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e pranimit të njëjtit. Ankesa në kopje të mjaftueshme i dorëzohet kësaj Gjykate Themelore.

